



**BASHKIA LEZHË**

**DOKUMENTI I  
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
2024-2026**

*Shtator, 2023*



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

**RELACION**  
**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM**  
**2024 – 2026**

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR .....	3
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË .....	5
<b>2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË.....</b>	<b>6</b>
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE .....	8
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË LEZHË .....	8
<b>3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË LEZHË .....</b>	<b>8</b>
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË .....	9
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT .....	10
<b>4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË LEZHË 2024-2026.....</b>	<b>11</b>
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË LEZHË NË VITET 2024-2026 .....	12
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Lezhë për vitet 2024-2026.....	12
2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Lezhë për periudhën 2024-2026.....	20
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR.....	
<b>5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE.....</b>	<b>25</b>
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit .....	
5.1.4 Të Dhëna mbi Programin .....	

## Lista e Tabelave

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Lezhë.....	
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit .....	
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.....	
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike.....	
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike.....	
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit.....	
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit .....	
Tabela 9. Të dhënat e Programit.....	

## 1. HYRJE

### 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore, transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjecare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një

bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të bashkisë në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxheti që bashkitë ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e bashkisë, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që bashkia planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. Bashkia, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standardeve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të bashkisë.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;

- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njëzia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendim-marrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e Bashkisë, Këshillin Bashkiak, GMS, Zyrtarin Autorizues, Zyrtarin Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2024-2026 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për bashkitë;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT).

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të bashkisë. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor bashkia, merret me finalizimin e dokumentit të

PBA-së dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, Grupi i Menaxhimit Strategjik përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të bashkisë. Projekt Buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të bashkisë për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Versioni përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të bashkisë.

## 2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

Programi Buxhetor Afatmesëm është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecar të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare, dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit.

Plani i Përgjithshëm Vendor shpjegon atë që bashkia synon të arrijë në fushat kryesore dhe të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të bashkisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Ato përshkruajnë mënyrën sesi bashkia synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, taksa e tarifat, huatë, dhe transferime nga qeveria qendrore (të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara).

Bashkia ofron shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallra e shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike etj).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave e burimeve gjithsej, përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektiveve të bashkisë me strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të bashkisë përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve. Bashkia ofron shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallra e shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike etj).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave e burimeve gjithsej, përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave e burimeve gjithsej, përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të bashkisë përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së, planifikimi e buxhetimi ndihmon njësinë të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson bashkië që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njëzia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të njësisë së vetëqeverisjes vendore në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike;
- përcakton qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese: *planifikimi dhe buxhetimi* që bashkia ndërmerr për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, dhe propozimet për buxhetin vjetor:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet, si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e bashkisë, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën trevjeçare, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, përcakton sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që bashkia planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të



shprehura në formën e produkteve SMART të programit. Specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit dhe standardeve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës për secilën fushë dhe të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësi, e më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si përdoren burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

## 2.1 Situata e Bashkisë Lezhë

Referuar treguesve kryesor financiar, situata e bashkisë paraqitet në gjendje të mirë financiare dhe e aftë për realizimin e operacioneve të saj financiare, pa krijuar situata dhe vështirësi likuiditetesh në kohë dhe mjete.

Në mënyrë të përmbledhur jepen treguesit financiarë si më poshtë :

		2021	2022	2023	2024	2025	2026
1	Totali i shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave						
	Shpenzimet e përgjithshme / Të ardhurave të përgjithshme	83.7%	88.9%	100%	100%	100%	100%
2	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore ndaj të ardhurave të veta						
	Taksat dhe tarifat vendore / Të ardhurat e veta	92.6%	96.0%	94.4%	95.4%	96.4%	98.3%
3	Të ardhurat nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave gjithsej						
	Të ardhurat nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	44.6%	33.6%	59.8%	59.3%	58.8%	58.6%
4	Shpenzimet kapitale ndaj totalit të shpenzimeve						
	Shpenzime kapitale / Shpenzimeve të përgjithshme	20.9%	23.7%	34.8%	37.3%	37.4%	37.8%
5	Shpenzime korrente ndaj shpenzimeve totale						
	Shpenzime korrente / Totali i shpenzimeve	31.9%	33.9%	30.2%	25.9%	25.4%	24.9%
6	Shpenzime për personelin ndaj totalit të shpenzimeve						
	Shpenzimet e personelit / Totali i shpenzimeve	47.2%	42.4%	35.0%	36.8%	37.2%	37.3%
7	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave						
	Huamarrja / Totali i të ardhurave	1.1%	0.85%	0.52%	0.0%	0.0%	0.0%
8	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta						
	Huamarrja / Totali i të ardhurave të veta	2.1%	2.53%	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%
9	Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të të ardhurave gjithsej						
		25.6%	21.0%	5.48%	0.0%	0.0%	0.0%
10	Shpenzimet për politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve						
		4.2%	6.0%	7.1%	4.9%	16.5%	6.7%
11	Shpenzime që mbështesin barazinë gjinore/totalit të shpenzimeve						
		49.6%	49.8%	50.0%	50.2%	50.3%	50.4%

## 2.2. Çështje kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë Lezhë

Politikat e bashkisë për projekte kryesore për vitet 2024-2026 janë në këto fusha për:

- Zhvillimin ekonomik, kryesisht ndërtimi i tregjeve lokale, magazinim produktesh, rehabilitim

e asfaltim rrugë rurale dhe urbane, ndërtim vendqëndrimi dhe parkingu për mjetet e transportit urban, projekte promovimi e zhvillimi të turizmit, kryesisht të atij malor në Njësinë Administrative Ungrej dhe ndërtim i pritave malore.

- Mbrojtjen nga zjarri e mbrojtjen civile, ndërtimi i një stacioni për MZSH në qytetin Shëngjin dhe hartimi i një plani studimor antipërmytje.
- Arsimin bazë dhe të mesëm, ndërtim dhe rikonstruksion objektsh të arsimit bazë e të mesëm dhe kopshti për fëmijë.
- Sportin, ndërtimi i dy parqeve sportive për fëmijët dhe të lojtrave me dorë.
- Kulturën, vendosja e Shtatores së Skenderbeut dhe restaurimi i shtëpisë së Zekaj.
- Përkujdesjen Sociale, ndërtimi i Qëndres të Moshës së Tretë dhe Qëndrës së Zhvillimit Ditor.

### 3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Lezhë

#### 3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

##### Politikat Strategjike:

- Platformë shkëmbimi dhe e kompletuar me logjistikë mbështetëse për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, energjisë dhe njerëzve:
- Qendër zhvillimi ekonomik tërheqës për investimet e huaja;
- Qendër urbane policentrike e pjesëshme që ofron shërbime cilësore ndaj qytetarëve të saj, dhe të vizitorëve.

##### Objektivat Strategjike:

- Objektiv Strategjikë 1: Turizëm i Qëndrueshëm. Lezha, hapësirë me potenciale turistike, vlera bujqësore, natyrore dhe kulturore.
- Objektiv Strategjikë 2: Industria Agro-Ushqimore. Lezha, pol bujqësor, atraktiv për investitorët strategjike në fushën e industrisë agro-ushqimore.
- Objektiv Strategjikë 3: Facilitete dhe Shërbime. Lezha për qytetarët, ku do të ofrojë shërbime efçente, cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

Lezha hyn në grupin e qendrave primare urbane, prandaj ajo duhet të vazhdojë të punojë në:

- Promovimin dhe zhvillimin e potencialeve turistike;
- Nxitjen dhe zhvillimin e vlerave bujqësore;
- Mbrojtjen nga rreziqet natyrore;
- Aksesimin e vlerave natyrore, kuzeale dhe kulturore përmes infrastrukturës me impakt të ulët në mjedis.

Detyra kryesore e zbatimit të strategjisë së zhvillimit afatgjatë është ajo e krijimit të mundësive për shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve lokale, duke përfshirë iniciativat për zhvillim urban në një kornizë më të gjërë, duke vlerësuar efektet, por mbi të gjitha duke saktësuar më qartë prespektivat e zhvillimit.

Në këtë drejtim mund, dhe duhet të punohet që planet e reja të jenë një mundësi për të tejkaluar dështimet e së shkuarës, duke ndërtuar një listë ndërhyrjes prioritare që të kenë kushtin e dyfishtë:

- Të jenë të sakta nga pikëpamja teknike,
- Të jenë të zbatueshme dhe të qëndrueshme nga pikëpamja ekonomiko-sociale.

Për të garantuar zhvillimin afatgjatë, Bashkia duhet të nxisë dhe zhvillojë këto tri asete të rëndësishme:

- Integrim dhe zhvillimi i mjedisit bregdetar me atë malor, pa rrezikuar që të dëmtohen dhe zhvlerësohen, duke garantuar një turizmë të qëndrueshëm;
- Kryerja e shërbimeve më të rëndësishme në qytete dhe zonat e tjera.

- Zhvillimi i bujqësisë nëpërmjet formave inovative të prodhimit dhe të tregtimit të produkteve bujqësore, si dhe mundësisë së integritit të saj me turizmin. Zhvillimi i industrisë agro-ushqimore.

### 3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore

Bashkia Lezhë po tregon një prirje të fortë për turizmin, zhvillimin e bujqësisë, përmirësimin e rrjeteve teknike, pra rrjeteve rrugore, ujësjellës dhe kanalizime, në zvogëlimin e nivelit të ndotjes mjedisore dhe ujrave nëntokësor, në menaxhim më të mirë të mbetjeve urbane, dhe në rikthimin e funksionalitetit të rrjetit të kanaleve ujitës dhe kullues, si dhe në përmirësimin e mbrotjes ndaj fenomenit të përmbytjeve.

Për të lehtësuar zhvillimin ekologjikisht të përshtatëshëm, dhe njëkohësisht për të garantuar që ai të ketë efektet e dëshiruara në zhvillimin e potencialit agro-turistik dhe agro-industrial në të gjithë territorin e bashkisë, janë të nevojshme këto projekte zhvillimi lokal:

- Realizimi i Portit Turistik të Shëngjinit dhe pajisja e tij me shërbime bazë për marinën turistike;
- Krijimi i një parku urban që të përfshijë lagunën Kune-Vain, por që kërkon ndërhyrje bonifikuese.
- Realizimi i pistave të biçikletave që lidhin plazhet e Ranës së Hedhun, Shëngjinit, Tales dhe lagunat.
- Realizimi i një zone për panairë të dedikuara për produktet bujqësore lokale.
- Realizimi i bypass-ve lindore dhe perëndimore të qytetit të Lezhës, me qëllim përmirësimin e trafikut.
- Ripyllëzimi i zonave bregdetare dhe disa zonave të brendshme të territorit, për të kompensuar dëmin e shkaktuar në mjedis dhe peizazheve të dëmtuara nga zhvillimet e pa-kontrolluara.

#### Projektet e reja për vitet 2024-2026

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi i projektit	Burimi i financimit	Projektet sipas viteve		
			2024	2025	2026
1	Rehabilitim dhe asfaltim rrugë urbane	Bashkia	172,758	-	200,000
2	Rehabilitim dhe asfaltim rrugë rurale	“	193,865	37,841	110,481
3	Ndërimi i Magazinës Frigorifike në Lezhë	“	150,000	-	-
4	Bashkëfinancim projektësh për zhvillimin ekonomik	“	5,000	5,000	5,000
5	Ndërtimi i Parkut të Lojrave për Fëmijë	“	64,463	-	-
6	Restaurimi i Shtëpisë së Zekajve	“	36,500	-	-
7	Ndërtim Parkingu për mjetet në qytetin Lezhë	“	-	95,838	-
8	Ndërtim Terminali të Autobuzëve në Shëngjin	“	-	161,854	-
9	Ndërtimi i Qëndres së Zhvillimit Ditor	“	-	200,000	-
10	Ndërtim Palestre në Sh.M.Bashkuar Zejmen	“	-	25,000	-
11	Ndërtim shtese shkolla Rrilë, Rik.Kopshti Skenderbej	“	-	85,260	16,700
12	Projekte Turizmi Malor në Nj.Administrative Ungrej	“	-	-	40,000
13	Ndërtimi i Parkut Lojrave me dorë	“	-	25,576	-
14	Vendosja e Shtatorës së Skenderbeut	“	-	-	10,000
15	Ndërtimi i Qëndres për Moshën e Tretë	“	-	-	23,000
16	Projekte promovimi turizmi	“	-	-	17,592
17	Ndërtim prita malore	“	-	-	25,000
18	Ndërtim i Stacionit Zjarrfikës në Shëngjin	“	-	-	30,000
19	Ndërtimi i Qëndres së Trajtimit të qenëve endacakë	“	-	-	50,000
20	Ndërtimi i Tregut të Gjësë së Gjallë	“	-	-	26,950
21	Ndërtimi i Tregut të Lëvizshëm në Shëngjin	“	-	-	20,000
22	Hartimi i Planit Studimor antipërmbytje	“	-	-	10,000

#### 4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË LEZHË 2024-2026

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Lezhë gjatë periudhës 2024-2026, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike.

Investimet sipas programeve për vitet 2021-2026

Në mijë lekë

Kodi	Programet	SHPENZIMET KAPITALE					
		Fakt 2021	Fakt 2022	Prit.2023	Plan2024	Plan 2025	Plan2026
AA127	Shërbime Administrative dhe Menaxheriale	3,327.3	21,618.4	26,543.1	3,000	3,000	27,343
AB127	Rendi dhe Siguria Publike	-	17,874.6	14,305.2	-	-	80,000
AC127	Çështje Përgjithshme Ekonomike	13,819.6	2,304.8	21,386.0	155,000	5,000	135,734
AD127	Infrastruktura e Shërbimet Publike	169,424.1	203,590.9	520,229.8	366,623	297,033	311,981
AE127	Turizmi dhe Kultura	-	-	19,716.0	37,000	500	75,092
AF127	Arsimi, Rinia dhe Sporti	21,568.9	7,360.4	19,997.0	64,771	136,144	16,700
AH127	Përkujdesja Sociale dhe Strehimi	1,448.0	21,664.2	10,995.8	-	200,000	23,000
<b>Totali</b>		<b>209,587.9</b>	<b>274,413.3</b>	<b>633,172.9</b>	<b>626,394</b>	<b>641,677</b>	<b>669,850</b>

#### Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Lezhë

		2019	2020	2021	2022	2023
Numri i Njësive Administrative	10					
Numri i Fshatrave	65					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	509.16					
<i>Qyteti</i>	5.41					
<i>Njësitë Administrative</i>	503.75					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	484.58					
<i>Zonë Urbane</i>	48.94					
<i>Tokë Bujqësore</i>	185.00					
<i>Kullota</i>	22.20					
<i>Pyje</i>	228.44					
Popullsia e Bashkisë		106,186	114,500	115,302	115,994	116,050
<i>Qyteti</i>		31,779	31,855	32,078	32,270	32,315
<i>Njësitë Administrative</i>		74,407	82,645	83,224	83,724	83,735
Mosha Mesatare e Popullsisë		36.7	37.2	37.7	38.2	38.5
Numri i Lindjeve		1,063	828	847	868	870
Numri i Vdekjeve		468	650	642	637	630
Numri i Bizneseve Aktive		3,018	2,124	2,968	3,005	3,570
Numri i Familjeve		33,088	47,948	48,284	48,574	48,595
<i>Qyteti</i>		9,836	9,922	10,009	10,097	10,115
<i>Njësitë Administrative</i>		23,252	38,026	38,275	38,477	38,480
Nr.Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		871	751	756	788	795
<i>Administrata e Bashkisë</i>		857	748	754	786	795
<i>Njësitë Shpenzuese</i>		14	3	2	2	0
Nr. Punonjësve të Bashkisë me kohë pjesëshme		50	50	50	39	20
<i>Administrata e Bashkisë</i>		50	50	50	39	20
<i>Njësitë Shpenzuese</i>		0	0	0	0	0
Numri i Programeve Buxhetore		27	29	28	29	18

## 4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Lezhë në vitet 2024-2026


### 4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Lezhë për vitet 2024-2026

Në burimet e të ardhurave, janë përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertat e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

TË ARDHURAT E BASHKISË SIPAS BURIMEVE PËR VITET 2021-2026 (në mijë lekë)

Nr	Emërtimi	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
1	Të Ardhurat Vendore	535,114	438,851	981,193	981,193	996,047	1,009,302	1,039,581
a-	Taksat vendore	254,040	138,198	560,000	560,000	574,000	588,000	605,641
b-	Taksat e ndara	69,974	76,489	44,550	44,550	45,664	46,778	48,181
c-	Tarifat vendore	171,663	206,778	322,053	322,053	330,103	338,155	348,299
d-	Të tjera	39,437	17,386	54,590	54,590	46,280	36,369	37,460
2	Transferta Pakushtëzuar	350,062	340,463	406,808	406,808	428,730	451,696	475,351
3	Transferta Sektoriale	226,492	244,010	251,749	251,749	254,266	256,809	259,377
4	Të Trashëguara	86,999	205,776	-	159,327	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>1,198,667</b>	<b>1,229,100</b>	<b>1,639,750</b>	<b>1,799,077</b>	<b>1,679,043</b>	<b>1,717,807</b>	<b>1,774,309</b>

TË ARDHURAT E BASHKISË SIPAS BURIMEVE (Në %)



BURIMET BUXHETORE		2021		2022		2023		2024		2025		2026	
		Fakti	Fakti	Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	I Pritshmi	Plani	Plani	Plani	Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	535,114	438,851	981,193	981,193	996,047	1,009,302	1,039,581					
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	254,040	138,198	560,000	560,000	574,000	588,000	605,641					
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	6,026	971	-	-	-	-	-					
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	99,604	96,532	160,000	160,000	164,000	168,000	173,040					
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	78,661	76,483	106,262	106,262	108,919	111,575	114,923					
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	5,105	6,011	25,459	25,459	26,096	26,732	27,534					
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	15,838	14,038	28,279	28,279	28,985	29,693	30,583					
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-					
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	9,663	10,810	50,000	50,000	51,250	52,500	54,075					
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga nd. e reja	133,225	27,135	335,000	335,000	343,375	351,750	362,303					
A.1.5	Taksa e tabelës	5,115	2,347	10,000	10,000	10,250	10,500	10,815					
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot.vendore	-	-	-	-	-	-	-					
A.1.7	Taksa e përkohëshme	408	403	5,000	5,000	5,125	5,250	5,408					
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	408	403	5,000	5,000	5,125	5,250	5,408					
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	-	-	-	-	-	-					
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	69,974	76,489	44,550	44,550	45,664	46,778	48,181					
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	9,986	8,335	9,000	9,000	9,225	9,450	9,734					
A.2.2	Taksa vjetore për e mjetet e përdorura	40,334	46,093	35,000	35,000	35,875	36,750	37,852					
A.2.3	Taksa e rentës minerare	500	317	550	550	564	578	595					
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	19,154	21,744	-	-	-	-	-					
A.2.5	Taksa të tjera	-	-	-	-	-	-	-					
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	171,663	206,779	322,053	322,053	330,103	338,155	348,299					
A.3.1	Tarifat me menaxhimin te mbejteve	61,805	90,570	88,000	88,000	90,200	92,400	95,171					

A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	20,198	30,351	27,546	27,546	27,546	28,235	28,924	29,791
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	688	950	974	974	974	998	1,022	1,053
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	40,919	59,269	59,480	59,480	59,480	60,967	62,454	64,327
<b>A.3.2</b>	<b>Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.3.3</b>	<b>Tarifa për ndriçimin publik</b>	17,784	11,814	34,700	34,700	34,700	35,568	36,435	37,528
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	5,752	3,804	8,556	8,556	8,556	8,770	8,984	9,253
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	207	250	254	254	254	260	266	275
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	11,825	7,760	25,890	25,890	25,890	26,538	27,185	28,000
<b>A.3.4</b>	<b>Tarifa për gjelbërimin</b>	18,780	9,880	33,400	33,400	33,400	34,235	35,070	36,122
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	5,117	3,880	8,106	8,106	8,106	8,308	8,511	8,766
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	262	238	240	240	240	247	253	261
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	13,401	5,762	25,054	25,054	25,054	25,680	26,306	27,095
<b>A.3.5</b>	<b>Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë</b>	64,755	80,681	136,682	136,682	136,682	140,096	143,514	147,820
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	400	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.2	Tarifa për dhënie të licensave, lejeve e autorizimeve	2,000	4,403	11,451	11,451	11,451	11,735	12,022	12,383
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	9,742	12,673	12,000	12,000	12,000	12,300	12,600	12,978
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	630	138	-	-	-	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	899	862	947	947	947	970	994	1,024
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licënuara dhe vendparkime publike	7,891	7,826	10,255	10,255	10,255	10,511	10,768	11,091
A.3.5.7	Tarifa për dhënie licëne për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	57	48	529	529	529	542	555	572
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksjja	1,070	998	1,500	1,500	1,500	1,538	1,575	1,622
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	42,066	53,733	100,000	100,000	100,000	102,500	105,000	108,150
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksove (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankaand etj	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>A.3.6</b>	<b>Tarifa të institucioneve arsimit, kulturës, sportit</b>	8,529	11,895	15,371	15,371	15,371	15,756	16,141	16,625

A.3.6.1	Biblioteka	-	-	-	35	35	36	37	38
A.3.6.2	Muzeumet	819	1,548	1,250	1,250	1,250	1,281	1,313	1,352
A.3.6.3	Teatri	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	70	70	70	72	74	76
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	69	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshret	6,061	8,126	10,500	10,500	10,500	10,763	11,025	11,356
A.3.6.9	Çerdhjet	1,580	2,221	3,516	3,516	3,516	3,604	3,692	3,803
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	10	6	-	-	-	-	-	-
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	-	1,933	13,900	13,900	13,900	14,248	14,595	15,033
A.4	Të Ardhurat e Tjera	39,437	17,386	54,590	54,590	54,590	46,280	36,369	37,460
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	7,604	219	8,385	8,385	8,385	8,595	8,804	9,068
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	10,500	7,829	7,080	7,080	7,080	7,257	7,434	7,657
A.4.8	Sekuestreime dhe Zhdëmtime	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	18,767	1,474	39,000	39,000	39,000	30,300	20,000	20,600
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	1,183	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	1,383	7,864	125	125	125	128	131	135




B	Transferta nga Buxheti Qendror	576,554	584,473	658,557	658,557	682,996	708,505	734,728
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	350,062	340,463	406,808	406,808	428,730	451,696	475,351
B.2	Transferta e Kushtëzuar	-	-	-	-	-	-	-
B.2.1	Për funksionet e deleguara	-	-	-	-	-	-	-
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	-	-	-	-	-	-	-
B.3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	226,492	244,010	251,749	251,749	254,266	256,809	259,377
C	Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
C.1	Huamarrja Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-
C.2	Huamarrja Afatgjatë	-	-	-	-	-	-	-
D	Trashëgimi nga viti paraardhës	86,999	205,776	-	159,327	-	-	-
D.1	Trashëgimi pa destinacion	79,002	183,003	-	109,643	-	-	-
D.2	Trashëgimi me destinacion	7,997	22,773	-	49,684	-	-	-
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË</b>		<b>1,198,667</b>	<b>1,229,100</b>	<b>1,639,750</b>	<b>1,799,077</b>	<b>1,679,043</b>	<b>1,717,807</b>	<b>1,774,309</b>

#### 4.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Lezhë

Informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së.

Paraqitja grafike e të ardhura vendore për vitet 2021-2026



### A. Taksat dhe Tarifat Vendore

#### A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Faktorët e rritjes apo të uljes së të ardhurave gjatë viteve 2024-2026 janë:

- rritja e numrit dhe në shtrirjen e mëtejshme të taksapaguesve;
- përmirësimi i performancës në mbledhjen e të ardhurave;
- dixhitalizimi i sistemit të të dhënave dhe të informacionit për çdo taksapagues;
- përdorimi më i mirë i potencialit tatimor;
- faktorët e tjerë, si ndërgjegjësimi i qytetarëve për pagesën e taksave dhe nga rritja ekonomike.

A.1.1 Për taksën vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël ndryshimet vijnë si rezultat i ndryshimeve ligjore.

A.1.2.1 Për taksën mbi ndërtesat ndryshimet vijnë si rezultat i shtimit të sipërfaqeve dhe përmirësimi i përdorimit të potencialit tatimor.

A.1.2.2 Për taksën mbi tokën bujqësore ndryshimet vijnë si rezultat i përmirësimit të përdorimit të potencialit tatimor.

A.1.2.3 Për taksën mbi truallin ndryshimet vijnë nga identifikimi dhe përmirësimi i përdorimit

të potencialit tatimor, si dhe të dhënave mbi trojet.

A.1.3 Për taksën vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier ndryshimet vijnë si rezultat i përmirësimit të përdorimit të potencialit tatimor.

A.1.4 Për taksën e ndikimit të infrastrukturës ndryshimet vijnë si rezultat i shtimit të sipërfaqeve të ndërtimit që do të jepen sipas PDV-ve dhe lejeve të ndërtimit.

A.1.5 Për taksën e tabelës ndryshimet vijnë si rezultat i përmirësimit të përdorimit të potencialit tatimor.

A.1.7 Për taksat e përkohshme që aplikohen vetëm për bizneset e mëdha ndryshimet vijnë si rezultat i përmirësimit të përdorimit të potencialit tatimor.

## A.2. Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A.2.1 Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97% e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

